

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1140/3 prot.

Vlorë, më 02.10.2018

**VENDIM**

**Nr. 61, datë 21.09.2018**

**PËR  
PËR DHËNIEN E TITULLIT "DOCTOR HONORIS CAUSA"  
PROF. MATTEO MANDALÀ**

Mbështetur në kreun II, pika 2.6 të VKM, nr. 467, datë 18.07.2007 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për kualifikimin shkencor dhe pedagogjik të personelit akademik", i ndryshuar me VKM, nr. 91, datë 10.02.2010, si dhe në propozimin e Departamentit të Financës për dhënie të titullit "Doctor Honoris Causa" Gene L. Dodaro-s, Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.09.2018

**VENDOSI:**



1. Të miratojë dhënie të titullit "Doctor Honoris Causa" Gene L. Dodaro-s.
2. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Roland ZISI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT

Nr. 235 prot.

Vlorë, më 19.09.2018

**Lënda:** Propozim për dhënie titulli *Honoris Causa*

**KRYETARIT PROF. DR. ROLAND ZISI**  
Senatit Akademik, Universiteti 'Ismael Qemali', Vlorë

**DEKANIT PROF. DR. ALBERT QARRI**  
Fakultetit i Ekonomisë, Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë

I nderuar Prof. ZISI, Kryetar i Senatit Akademik,

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë, mbledhur në dt. 19 Shtator 2018, bazuar në shkresën me nr 1062 Prot., datë 12.09.2018 të Kryetarit të Kontrollit të lartë të Shtetit Z. Bujar Leskaj, drejtuar Rektorit të Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë, Prof.Dr. Roland Zisi, mbeshteti njëzëri propozimin e paraqitur në shkresën sipërcituar për t'i propozuar Senatit Akademik të UV-së dhënien e titullit *Honoris Causa* **Z. Gene L. Dodaro**, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

**Z. Gene L. Dodaro**, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO), ka dhënë një kontribut të spikatur në forcimin e mardhënieve dypalëshe mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**  
**FAKULTETI I EKONOMISË**  
**DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT**

Per arsyet e mësipërme, do të ishte në nderin e Institucionit tonë dhe të Senatit Akademik, dhënia e titullit *Honoris Causa* **Z. Gene L. Dodaro**.

Shpresojmë që propozimi i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit të merret në konsideratë.

**DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË FINANCËS DHE KONTABILITETIT**

**Prof. As. Dr. Filloreta Madani**

Kydokumentpërpilohet në 3 (tre) kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Nr. 1062 Prot.

Tiranë, më 12/09/2018

Lënda: *Kërkesë për dhënien e titullit "Honoris Causa" z. Gene L. Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës*

Drejtuar: Prof. Roland ZISI  
Rektor  
Universiteti "Ismail Qemali"

V L O R Ë

*I nderuar z. Rektor,*

Në cilësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit kam privilegjin t'ju paraqes kërkesën për dhënien e titullit "Honoris Causa" z. Gene L. Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO), personaliteti me kryesor i komunitetit të institucioneve supreme të auditimit, njëri prej bashkëpunëtorëve të huaj me më shumë kontribute për Kontrollin e Lartë të Shtetit në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të tij dhe të modernizimit të Institucionit, në mënyrë që auditimi i jashtëm në Shqipëri të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit).

Zoti Gene L. Dodaro është diplomuar për kontabilitet nga Kolegji Lycoming në Williamsport, Pensilvani, është anëtar i Akademisë Kombëtare të Administratës Publike dhe anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Qeverisë. Ai është vlerësuar nga organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit gjatë karrierës së tij 40 vjeçare, duke përfshirë Çmimin për Shërbimin Publik Kombëtar nga Shoqata Amerikane për Administratën Publike dhe Akademia Kombëtare e Administratës Publike, Çmimin Roger W. Jones nga Universiteti Amerikan dhe Çmimin Braden nga Departamenti i Kontabilitetit në Universitetin Case Western Reserve. Nga viti 1999 deri në vitin 2008, ai mbajti pozicionin e Asistentit Kryesor (nr.2 në GAO) të Kontrollorit të Përgjithshëm. Nga vitin 2008 deri në vitin 2010 ishte Kontrollor i Përgjithshëm në detyrë i GAOs dhe në dhjetor 2010 u zgjodh nga Senati Amerikan për një mandat të plotë në krye të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (2010-2025).

Z. Dodaro gëzon një vlerësim të veçantë në komunitetin e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe ka një kontribut të jashtëzakonshëm në hartimin e Planeve Strategjike 2011-2016 dhe 2017-2022 të INTOSAI-t, si ideator dhe hartues i drejtperdrejtë i tyre. Këto plane ambicioze synojnë

t'i vijnë në ndihmë SAI-eve në auditimin e përmbushjes së detyrimeve të marra nga vendet anëtare të OKB-së për realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendes 2030.

Kontrollori i Përgjithshëm i GAO-s ka dhënë një kontribut të spikatur në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Bashkëpunimi mes dy institucioneve ka nisur që në fillimet e viteve '90, në një klimë kur demokracia shqiptare ishte ende e brishtë dhe pavarësia institucionale ende në hapat e saj të parë.

Z. Dodaro ka treguar një vëmendje të veçantë për thellimin e bashkëpunimit me KLSH. Ky bashkëpunim ka kulmuar me pjesmarrjen e pesë audituesve të KLSH në trajnimin disamujor (*fellowship*) pranë GAO-s, trajnimi më i suksesshëm dhe më prestigjioz në fushën e auditimit publik, i ofruar nga Zyra e Auditimit të Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pjesmarrja e audituesve të KLSH në këtë trajnim ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përfitimin e dijeve dhe eksperiencës tejet cilësore dhe mjaft të domosdoshme për rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH-së dhe modernizimin e institucionit.

Në datat 1 dhe 2 tetor 2018, z. Dodaro do të jetë në Tiranë për një vizitë zyrtare, gjatë së cilës do të diskutohet për plane konkrete veprimi mes dy institucioneve, me qëllim realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për periudhën në vijim. Duke vlerësuar maksimalisht bashkëpunimin me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kontributin e mbështetjen konkrete që z. Dodaro dhe institucioni i drejtuar prej tij kanë dhënë për rritjen cilësore të kapaciteteve audituese të punonjësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së ndjehem i nderuar të paraqes pranë Jush kërkesën për dhënie të titullit "*Honoris Causa*" për z. Gene L. Dodaro dhe kam shpresën se kjo kërkesë do të merret në konsideratë, pasi jam i bindur se vlerësimi i karrierës së z. Dodaro është vlerësim në veçanti për Institucionin Suprem të Auditimit në Shqipëri, KLSH-në edhe për Universitetin "Ismail Qemali".

me respekt,

KRYETAR

Bujar LESKAJ